




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME**  
**Komiteti për Politikë dhe financa**  
Nr.01-060/01-30553/23 datë: 17.11.2023



Npi – 01/414 datë: 23.11.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 23.11.2023 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**  
E mbajtur më datën: 23.11.2023 (e enjte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Nga ZKF znj.Kimete Ukaj, nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, znj.Genta Mehmeti dhe Praktikantët znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023,
2. Propozim-Vendim për Normat Tatimore për vitin 2024,
3. Raporti 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023,
4. Raporti i Auditimit të Jashtëm të Komunës së Shtimes për vitin financiar 2022,
5. Raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm për vitin 2022,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).
7. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore,
8. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për diskutim publik),
9. Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)
10. Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Diskutim Publik)
11. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024,
12. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/54 dt. 28.03.2022, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
13. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/139 dt. 31.05.2022, për plotësimin e KASHPU me anëtarë të ri,
14. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt 27.04.2023 të Komis. të Aksionarëve të KRM 'Pastërtia'

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës e njoftoi KPF-në për vendimin e Gjykatës Kushtetuese i cili e ka lënë të hapur mundësinë që Komunitet me vendos vet nëse duan të u falin 100 euro tatimpaguesve të komunës së vetë. Hapi diskutimin për rendin e ditës. **z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës edhe me pikën shtesë që të futet, ndërsa pika e 12 “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/54 dt. 28.03.2022, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri” propozojë që të mos diskutohet fare por të shkojë direkt në Kuvend. **z.Kadri Emini;** Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës edhe me pikën shtesë. Sa i përket KPF-së ne e kemi një rekomandim që KPF-ja të plotësohet sipas rekomandimit të MAPL-së.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pajtohem me propozimin e Përparimit që me hjekë pikën e 12 sepse e kemi një rekomandim nga mbledhja e kaluar, po ashtu jam që ta fusim si pikë shtesë si pika e 12 “Faljen e 100 eurove tatimpaguesve të Komunës së Shtimes për vitin 2023”.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Rendin e ditës si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023,
2. Propozim-Vendim për Normat Tatimore për vitin 2024,
3. Raporti 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023,
4. Raporti i Auditimit të Jashtëm të Komunës së Shtimes për vitin financiar 2022,
5. Raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm për vitin 2022,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).
7. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore,
8. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për diskutim publik),
9. Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)
10. Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Diskutim Publik)
11. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024,
12. Propozim-Vendim për faljen e 100 eurove tatimpaguesve të komunës së Shtimes për vitin 2023, (Pikë shtesë)
13. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/139 dt. 31.05.2022, për plotësimin e KASHPU me anëtarë të ri,
14. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt 27.04.2023 të Komis. të Aksionarëve të KRM 'Pastërtia'

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.08.2023.**

Pika 2

Propozim-Vendim për Normat Tatimore për vitin 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

**znj.Kimete Ukaj, ZKF;** Përshëndetje, tash me ligjin e ri nuk kemi më rregullore por vetëm vendim për normat tatimore komunale. Në vazhdim lexoi dokumentin e normave tatimore. (Shih dokumentin)

**z.Kadri Emini;** Kam një pyetje për ZKF-në, këto norma tatimore a janë të ngjashme sikurse me rregulloren e mëparshme, edhe si caktohet vlersimi i pronave?

**znj.Kimete Ukaj, ZKF;** Bazë për vlerësimin e pronave është Kontrata e shit-blerjes si vlerë, por ka edhe elemente të tjera që merren parasysh për vlerësimin e pronave që e bën Komisioni i posaqem nga Ministria e Financave.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit, Kimetes i uroj për punën dhe detyrën e re. Unë propozojë që për secilën normë tatimore të shkojmë në minimum.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Ju po jepni si propozim me shku në minimum, e ne duhet ta analizojmë deri në mbledhjen e Kuvendit.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për normat tatimore për vitin 2024 me normën tatimore në minimum, pasi ta sqarojë ZKF-ja në Kuvend.**

#### Pika 3

##### Raporti 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Në vazhdim e lexoi dokumentin e raportit sipas Kategorive Ekonomike me shifra konkrete, më pastaj edhe bëri krahasimet e shpenzimeve nga viti i kaluar (shih dokumentin).

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" (me votën e dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit, sipas nenit 48.1 të LVL-së Nr.03/L-040) me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit miratimin e Raportit 9 mujor Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Shtator 2023.**

#### Pika 4

##### Raporti i Auditimit të Jashtëm të Komunës së Shtimes për vitin financiar 2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Raporti nuk votohet, është raport i mirë që është vlerësuar si "I pa kualifikuar". Ne e kemi obligim ligjor që raportin e Auditorit të jashtëm me e prezantuar në Kuvend, ju dokumentin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar kështu që unë nuk do ta zgjati diskutimin tim më shumë, por nëse ka pyetje unë do të përgjigjem.

**z.Kadri Emini;** Lidhur me Auditimet që kryhen, unë mendoj se është e pamundur që Auditori mos me gjetë gabime, por ajo që është e rëndësishme është që Rekomandimet të mos përsëriten.

#### Pika 5

##### Raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm për vitin 2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Edhe për këtë pikë materialin e keni marrë me kohë, ku i kemi paraqitur të dhënat e sakta se Auditori i jashtëm i ka të evidentuara 12 të gjetura. Ky raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit nuk votohet në Kuvend por ne e kemi për obligim ligjor me e prezantuar në Kuvend. U tha që i kemi 12 të gjetura, ku 6 prej tyre janë të përsëritura dhe 6 rekomandime janë të reja, dhe janë në procedurë të zbatimit të tyre. (Shih dokumentin)

#### Pika 6

##### Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Siç e dini kjo ka kaluar por kemi një rekomandim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturë për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit të Kuvendit për programin e banimit social 2023-2025 me numër Npi-01/271 të miratuar nga Kuvendi më 18.07.2023. E hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi t'i rekomandon Kuvendit miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).**

#### Pika 7

##### Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dokumenti si propozim e kemi nga DKA-ja me emrat e anëtarëve të Komisionit që duhet votuar për ta, unë e hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Sa e di unë për këtë pikë e kemi bërë një Rekomandim në mbledhjen e kaluar të KPF-së, prandaj i rekomandojmë Kuvendit që t'i zgjedhë anëtarët Komisionit, pasi që drejtoresha të na jep sqarime shtesë për emrat e anëtarëve të propozuar të Komisionit.

**z.Kadri Emini;** Nëse kemi rekomandim atëherë nuk kemi pse të diskutojmë, jam që të aprohet në Kuvend.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Edhe unë jam që t'i rekomandojmë Kuvendit miratimin e Komisionit.  
**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore, me arsyetimin që Drejtoresha e Arsimit të jap sqarime në Kuvend për anëtarët e propozuar të Komisionit.**

#### Pika 8

Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për diskutim publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

**z.Grejtalb Emini, DPUKGj;** Përshëndetje, Propozim-rregulloren e keni pranuar më herët dhe keni pas mundësi mjaftueshëm për ta lexuar. Meqenëse kjo ka me shku në diskutim publik atëher të gjithë do ta kanë mundësinë për me i dhënë komentet e tyre. Ju ftoj që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

**z.Përparim Ramusa;** Meqenëse Ligji po e lejojka një rregullore të tillë nuk kemi arsye për mos me e votuar. Ne si grup parlamentar i PDK-së jemi që t'i rekomandojmë Kuvendit, që ta miratoj vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim, pronën komunale për më pak se një vit. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Zyra për Informim.**

#### Pika 9

Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Për diskutim Publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra për Informim.**

#### Pika 10

Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Për diskutim Publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Kastriot Shabani.

**z.Kastriot Shabani, DZHE;** Përshëndetje, kjo draft-strategji ka me shku në diskutim publik atëher të gjithë kanë mundësinë me i dhënë komentet e tyre. Dokumentin e keni pranuar më herët dhe keni pas mundësi për ta lexuar. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

**z.Përparim Ramusa;** Ne si grup parlamentar i PDK-së jemi që të shkoj në diskutim publik.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Strategjin e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2027. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe Zyra për Informim.**

#### Pika 11

Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024, me kërkesën që subjektet politike ti sjellin propozimet e tyre në mbledhjen e Kuvendit**

Pika 12 (Pikë Shtesë)

Propozim-Vendim për faljen e 100 eurove tatimpaguesve të komunës së Shtimes për vitin 2023  
**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Ne e kemi një Rekomandim të mëhershëm për këtë pikë, propozoj të mos e përsërisim atë dhe ta qesim në Kuvend për miratim.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për faljen e 100 euro tatimpaguesve të komunës së Shtimes për vitin 2023. (Rekomandimet nga mbledhja e KPF-së Npi – 01/302 datë:29.08.2023, pika 3).**

Pika 13

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/139 dt. 31.05.2022, për plotësimin e KASHPU me anëtarë të ri

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sa i përket Komiteteve jo obligative unë mendoj se edhe këto Komitete duhet të paguhen dhe duhet të diksutohet për to.

**z.Përparim Ramusa;** I rekomandojmë Kuvendit që të plotësoj Komitetet dhe të gjejë formë për me i paguar.

**z.Lumni Amrushi;** Sa i përket pagesave unë e kam një shqetësim sepse kanë ndodhur disa mos pagesa. Uroj që në vitin 2024 të mos ndodhin.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për plotësimin me anëtar të ri Komitetin për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm.**

Pika 14

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt 27.04.2023 të Komisionit të Aksionarëve për K.R.M 'Pastërtia' njësia në Shtime

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Në emër të PDK-së ne jemi kundër që të ndryshohet ky vendim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Propozoj që propozimet për Komision të bëhen në Kuvend.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” (me votën e dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit, sipas nenit 48.1 të LVL-së Nr.03/L-040) me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t'i Rekomandon Kuvendit miratimin e Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt. 27.04.2023 të Komisionit të Aksionarëve për K.R.M 'Pastërtia' njësia në**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 15:20h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi